



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi Komunal Dragash - Skupština Opštine Dragash

01 Nr.020/01-2131/1

Dt. 28.02.2017

Kuvendi Komunal i Dragashit në seancën e dt.28.02.2017, pas shqyrtimit paraprak të Raportit Financiar për realizimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2016, si dhe për shkak të shtimit të mjeteve nga të hyrat vetanake për vitin 2016, në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të komunës së Dragashit, miraton këtë:

V E N D I M
PËR SHTIMIN E BUXHETIT NGA TË HYRAT VETANAKE, PËR VITIN 2016

- I. Mjetet vetanake buxhetore për vitin 2016 të grumbulluara më tepër në raport me Planin kapin shumën prej 18,128.30 euro.
- II. Shuma e mjeteve të gjithëmbarshme nga të hyrat vetanake për vitin 2016 është 418,128.30 euro.
- III. Mjetet e grumbulluara më tepër në vitin 2016 nga pika I e këtij vendimi do të vendosën në programet buxhetore të Zyrës së Kuvendit dhe zyrës së Kryetarit dhe do të shpenzohen:

Nr.r..	Organizata buxhetore	Programi buxhetor	Projekti	Kat.ekonomike. buxhetore	Fondi	Shuma
1	621	Zyra e Kuvendit	Mallra dhe Shërbime-13	13	21	8,128.30
2	621	Zyra e Kryetarit	Subvencione dhe transfere	20	21	10,000.00
Totali						18,128.30

- IV. Ky Vendim hyn në fuqi nga data e miratimit dhe do të implementohet përmes departamentit të Buxhetit të MF-së të Republikës së Kosovës.



Kryesuesi i Kuvendit
Shaban Shabani